



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

DOKUMENTAT STANDARDE
TË PROCEDURËS SË HAPUR
MALLRA ¹

OBJEKTI: **Blerje Kite dhe Reagentë, për nevojat e NJVKSH”, për mbulimin e nevojave të NJVKSH për 12 muaj**

FONDI LIMIT TOTAL: **Vlerë e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë MK: 8’617’550 (tetë milion e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH.**

Shumatore Çmimi për Njësi: 330.185,03 (treqind e tridhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë presje zero tre) Lekë me TVSH;

NR. REF: **REF-72666-09-22-2020**

¹

Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash autoriteti kontraktor do ti referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi.

I NJOFTIMI I KONTRATËS

Seksioni 1. Autoriteti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë
Adresa Rruga "Qamil Guranjaku,, Tirane
Tel/Fax Tel. +355 4347439
E-mail njvkshtirane@shendetesia.gov.al
(briken.lala@qsut.gov.al)
Faqja e Internetit _____

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

Institucion qëndror	Institucion i pavarur
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Njesi e qeverisjes vendore	Tjetër
<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

1.3 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër

Po Jo

Seksioni 2. Objekti i kontratës

2.1 Numri i referencës së procedurës: REF-72666-09-22-2020

2.2 Lloji i "Kontratave Publike për Mallra"

Blerje	Qira	Leasing	Blerje me këste	Një kombinim i tyre
<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po Jo

2.4 Lloji i Marreveshjes Kuadër

Me një Operator Ekonomik
Me disa operatorë ekonomikë
Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po Jo

Në Marrëveshjen Kuadër me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, të jepen arsyet e përzgjedhjes së kësaj lloj Marrëveshje Kuadër.

Kjo lloj marrëveshje (Marrëveshje Kuadër me një OE me të gjitha kushtet e përcaktuara), e bazuar në nenin 35/1, pika 5 e LPP dhe 47, pika 1/a dhe pika 2 e RrPP, është zgjedhur për shkak të mundësisë së kufizuar të alternativave për kite dhe reagentë sipas specifikave të kërkuara nga AK. Lidhur me prokurimin e këtij objekti, janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të marrëveshjes kuadër për sa i përket artikujve, specifikimet e sakta teknike, kushtet e rëndësishme të lëvrimit si dhe sasitë e pritshme të kërkuara. Për sa i përket sasive që do të nevojiten, AK nuk është në gjendje të parashikojë me saktësi sasitë e nevojshme për çdo artikull. Është zgjedhur kjo procedurë për arsye të mbulimit të shërbimit me mallin e kërkuar gjatë gjithë kohës duke u nisur nga vetë specifika që ka AK (NJVKSH). Në një marrëveshje, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, lëvrimi i mallit nga disa operatore ekonomike (nëpërmjet procedurës së mini-konkurimit) nuk është i favorshëm pasi krijon vështirësi autoritetit kontraktor për furnizim me sasinë e kërkuar në kohën e duhur, çka do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksesshëm, gjë që do të shoqërohej me rritjen e afateve të lëvrimit duke shkakruar vonesa në ofrimin e mallit ,dhe si rrjedhojë do të ndikonte në mënyrë direkte në shëndetin e pacientit. Lidhja e MK me një OE të vetëm si dhe me të gjitha kushtet e përcaktuara, do të shoqërohej me mirë-organizimin e procedurës për sigurimin e mallrave në kohë, sigurimin e një rezerve për mbulimin e nevojave të pacientëve si dhe furnizimin në kohën e kërkuar nga AK.

2.5 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të përfundojë Marrëveshja Kuadër: 1 (një) (Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër).

2.6	Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike .	Nuk do të ketë rihapje të konkursit. Kontratat do të lidhen sipas kërkesave të AK, me operatorin ekonomik më të suksesshëm, i cili do të ofrojë cmimin më të ulët për njësi për artikujr objekt prokurimi dhe vlerën e pritshme më të ulët.
------------	--	---

2.7 Autoriteti kontraktor/Autoritetet kontraktore të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër:
Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë

2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër

Dokumentat Standarde të Tenderit

Nr	Artikulli	Përshkrimi	Sasia	Njësia	Shumatore Çmim për një njësi	VLERË PA TVSH	TVSH	VLERË ME TVSH
1	Acid Sulforik	Reagent analitik me pastërti $\geq 95 - 98 \%$, Acid, i lëngët, pa ngjyrë ose ngjyrë të lehtë të verdhë. Me aromë të fortë shpuese Emri sipas IUPAC*: Sulfuric acid Formula Kimike: H_2SO_4	2,50	Lit				
2*	NES SLE R	Reagent analitik, i lëngët, me ngjyrë të verdhë të lehtë i përdorur në përcaktimin e amoniakut dhe kripërave të tij. Emri sipas IUPAC: Potassium tetraiodomercurate (2) Formula Kimike: K_2HgI_4	12,50	Lit				
3*	DPD 1	Tableta për matjen e klorit të lirë me limit dedektimi 0.01 – 6 mg/l Emri sipas IUPAC: N, N – diethyl – p – phenylenediamine Formula Kimike: $C_6H_{16}N_2$	8.500,00	Tableta				
4	Acid Fosforik	Reagent analitik me pastërti $\geq 85 \%$, Acid, i lëngët, pa ngjyrë dhe pa aromë. Emri sipas IUPAC: Phosphoric acid Formula Kimike: H_3PO_4	1,00	Lit				
5	Ampula dioksid karboni	Matje e gazeve në mënyrë manuale me anë të aparatit Drager.	10,00	Copë (Ampulë)				
		Një kuti ka dhjetë ampula.						
6	Ampula toluol	Matje e gazeve në mënyrë manuale me anë të aparatit Drager.	10,00	Copë (Ampulë)				
		Një kuti ka dhjetë ampula.						
7	Ampula ksilol	Matje e gazeve në mënyrë manuale me anë të aparatit Drager.	10,00	Copë (Ampulë)				
		Një kuti ka dhjetë ampula.						

Dokumentat Standarde të Tenderit

8	Ampula hidri karbure aromatike	Matje e gazeve në mënyrë manuale me anë të aparatit Drager. Një kuti ka dhjetë ampula.	Kufiri i matjes 50 – 400 ppm	10,00	Copë (Ampulë)			
9	Jodur Kaliumi	Reagent analitik me pastërti ≥ 99%. Pluhur i bardhë, pa aromë. Emri sipas IUPAC: Potassium iodide Formula Kimike: KI		500,00	Gram			
10	Permanganat Kaliumi	Reagent analitik me pastërti ≥ 99 %. Pluhur me ngjyrë të purpurt të errët, pa aromë. Emri sipas IUPAC: Potassium manganate (VII) Formula Kimike: $KMnO_4$		1.000,00	Gram			
11	Fenolftaleinë	Phenolphthaleine. Reagent analitik me pastërti ≥ 98 %. I përdorur si indikator pasi tretet në ethanol. Pluhuri i bardhë pa aromë. Emri sipas IUPAC: 3,3-Bis(4-hydroxyphenyl)-2-benzofuran-1(3H)-one Formula Kimike: $C_{20}H_{14}O_4$		200,00	Gram			
12 *	NEDA	Reagent analitik me pastërti ≥ 98 %. Pluhur i bardhë kristalin, pa aromë. I përdorur në përcaktimin e nitriteve dhe nitrateve. Emri sipas IUPAC: N-(1-Naphthyl)Ethylenediamine Dihydrochloride Formula Kimike: $C_{12}H_{16}N_2Cl_2$		25,00	Gram			
13	Acid klorhidrik	Muratic acid. Reagent analitik 37 %. Acid i lëngët, pa ngjyrë dhe me aromë të fortë shpuese. Emri sipas IUPAC: Hydrochloric acid Formula Kimike: HCl		2,50	Lit			
14 *	Acid oksalik	Acid oxalic. Reagent analitik me pastërti ≥ 99.5 %. Pluhur i bardhë, kristalin, pa aromë. Emri sipas IUPAC: Ethanedioic acid Formula Kimike: $C_2H_2O_4$		500,00	Gram			

Dokumentat Standarde të Tenderit

15	Alkohol etilik	Reagent analitik me pastërti \geq 99.5 %. I lëngët, pa ngjyrë me aromë karakteristike të alkoolit. Emri sipas IUPAC: Ethanol Formula Kimike: C_2H_6O	6,00	Lit			
16*	Nitrat argjendi	Reagent analitik me pastërti \geq 99.5 %. Patretshmëria në ujë max 50 ppm. Pluhur kristalin, me ngjyrë të bardhë. Emri sipas IUPAC: Silver nitrate Formula Kimike: $AgNO_3$	100,00	Gram			
17	Sulfat argjendi	Reagent analitik me pastërti \geq 98.5 %. Pluhur kristalin, me ngjyrë të bardhë. Emri sipas IUPAC: Silver sulfat Formula Kimike: Ag_2SO_4	450,00	Gram			
18	EDTA	Ethylenediaminetetraacetic acid. Reagent analitik me pastërti \geq 99 %. Pluhur i përbërë nga kristale pa ngjyrë. Emri sipas IUPAC: 2,2',2'',2'''-(Ethane-1,2-diyl)dinitrilo)tetraacetic acid Formula Kimike: $C_{10}H_{16}N_2O_8$	500,00	Gram			
19	Hidroksid natriumi	Reagent analitik me pastërti \geq 98 %. Substance bazike, inorganike. E përbërë nga copëza të bardha. Emri sipas IUPAC: Sodium hydroxide Formula Kimike: NaOH	1,00	Kg			
20	Hidroksid natriumi	Reagent analitik me përqëndrim 0.1 N. Solucion i standartizuar me saktësi 0.2 %. Emri sipas IUPAC: Sodium hydroxide Formula Kimike: NaOH	3,00	Flakone (Copë)			
21*	Kripë Seigneti	Reagent analitik me pastërti \geq 99 %. Pluhur i bardhë kristalin.	1,00	Kg			

Dokumentat Standarde të Tenderit

		Emri sipas IUPAC: Sodium potassium L(+)-tartrate tetrahydrate Formula Kimike: $\text{KNaC}_4\text{H}_4\text{O}_6 \cdot 4\text{H}_2\text{O}$					
22	Acet at plumbi	Reagent analitik me pastërti $\geq 99\%$. Pluhur i bardhë kristalin. Emri sipas IUPAC: Lead (II) acetate Formula Kimike: $\text{Pb}(\text{C}_2\text{H}_3\text{O}_2)_2$	1.000,00	Gram			
23	Eter petroli	Solvent i lëngët pa ngjyrë me temperaturë vlimi $40 - 60^\circ\text{C}$. Emri sipas IUPAC: Petroleum ether Formula Kimike: C_6H_{14}	8,00	Lit			
24 *	Difenil aminë	Reagent analitik me pastërti $\geq 99\%$. Pluhur me ngjyrë të bardhë në krem. Emri sipas IUPAC: Diphenylamine Formula Kimike: $\text{C}_{12}\text{H}_{11}\text{N}$	500,00	Gram			
25	Hidroksoni	Reagent analitik i përgatitur nga amoniaku i tretur në ujë me përqëndrim 28%. Lëng pa ngjyrë me aromë shpuese. Emri sipas IUPAC: Ammonium hydroxide Formula Kimike: NH_4OH	1,00	Lit			
26 *	Brucinë	Reagent analitik me pastërti $\geq 98\%$. Pluhur me ngjyrë të bardhë. Emri sipas IUPAC: 2,3-dimethoxystrychnidin-10-one Formula Kimike: $\text{C}_{23}\text{H}_{26}\text{N}_2\text{O}_4$	500,00	Gram			
27 *	Furfuroli	Reagent analitik me pastërti $\geq 98\%$. Lëng vajor pa ngjyrë. Emri sipas IUPAC: Furan-2-carbaldehyde Formula Kimike: $\text{C}_5\text{H}_4\text{O}_2$	1,00	Lit			
28	Metil Oranži	Reagent analitik me pastërti $\geq 99.9\%$. Indikator. Pluhur me ngjyrë të ndezur portokalli.	300,00	Gram			

Dokumentat Standarde të Tenderit

		Emri sipas IUPAC: Sodium 4-{{4-(dimethylamino)phenyl}diazonyl}benzene-1-sulfonate Formula Kimike: C ₁₄ H ₁₄ N ₃ NaO ₃ S					
29*	Kromat kaliumi	Reagent analitik me pastërti ≥ 99.5 %. Pluhur me ngjyrë të verdhë të ndezur. Emri sipas IUPAC: Potassium chromate Formula Kimike: K ₂ CrO ₄	500,00	Gram			
30	Klorofor	Reagent analitik me pastërti ≥ 99 % Solvent i lëngët pa ngjyrë. Emri sipas IUPAC: Trichloromethane Formula Kimike: CHCl ₃	2,50	Lit			
31*	Kite feçe gjak okult	Rapid test imunokromatografik; Test i shpejtë imunokromatografik për zbulimin e gjak okult në feçe me limit dedektimi 50 ng Hemoglobine/ ml	400,00	Teste			
32	Kite feçe Helicobacter Pylori	Rapid test imunokromatografik; Test i shpejtë për përcaktimin e Helicobacter Pylori në feçe shoqëruar me kontrollet. Ku kontrolli pozitiv të përmbajë antigenin Helicobacter Pylori (≥ 1µg/ml), < 0.1 % NaN ₃ . Me sensitivitet analitik 0.78 ng/ml	1.200,00	Teste			
33	Cryptosporidium + Giardia combi	Test për zbulimin e Giardia dhe Cryptosporidium. Me specifitet relativ për Giardia 98.5 % dhe Cryptosporidium 98.5 %. Me përgjigje të rezultatit për 15 min.	100,00	Teste			
34	Gonorrhea	Rapid test/ Test i shpejtë për identifikimin e antigenit Gonorrhea, shoqëruar me kontrollet. Me limit dedektimi për Neisseria gonorrhoeae 1x10 ⁵ CFU/ml. Një kuti ka 25 teste.	1,00	Kuti			
35	Nystatine	Anti mykotik. Një flakon ka 50 disqe.	2,00	Flakon			
36	Econazole	Anti mykotik. Një flakon ka 50 disqe.	3,00	Flakon			

Dokumentat Standarde të Tenderit

37	Clotrimazole	Anti mykotik. Një flakon ka 50 disqe.	1,00	Flakon				
38	Ketoconazole	Anti mykotik. Një flakon ka 50 disqe.	1,00	Flakon				
39	Miconazole	Anti mykotik. Një flakon ka 50 disqe.	2,00	Flakon				
40	Fluconazole	Anti mykotik. Një flakon ka 50 disqe.	1,00	Flakon				
41	Amphotericin B	Anti mykotik. Një flakon ka 50 disqe.	1,00	Flakon				
42	Itraconazole	Anti mykotik. Një flakon ka 50 disqe.	5,00	Flakon				
43	Tubaprep	Vakuteste	#####	Copë				
44	Kriotuba	Për ruajtjen e serumeve	1.000,00	Copë				
45*	HIV 1 dhe HIV2	Kasete. Rapid test/ Test i shpejte imunokromatografik për zbulimin e antitropave të HIV1 dhe HIV2 në gjak dhe serum.	7.500,00	Teste (Copë)				
46	HBS AG	Kasete. Rapid test/ Test i shpejtë imunokromatografik për përcaktimin e antigenit sipërfaqësor të Hepatitis B në serum ose plazma.	3.720,00	Teste (Copë)				
47*	Anti HCV	Kasete. Test i shpejtë imunokromatografik për zbulimin cilësor të antitropave të hepatitisit C në serum, plazëm ose gjak, me sensitivitet 99.3 % për HCV	1.220,00	Teste (Copë)				
48*	Syphilis	Kasete. Test i shpejtë imunokromatografik për përcaktimin e Syphilis.	720,00	Copë				
49*	Pepton universal	Pluhur, ngjyrë bezhë i përdorur në përgatitjen e tereneve mikrobiologjike. Tretet mirë në ujë.	86,00	Kg				

Dokumentat Standarde të Tenderit

50	Lakt ozë	Pluhur i bardhë, i përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike. Tretet mirë në ujë.	12,00	Kg			
51	NaCl	Reagent analitik me pastërti \geq 99.5 %	8,00	Kg			
52	K_2HPO_4	Dipotassium phosphate. Pluhur i bardhë. I përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike. Tretet mirë në ujë.	25,00	Kg			
53	KH_2PO_4	Monopotassium phosphate. Pluhur i bardhë. I përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike. Tretet mirë në ujë.	12,50	Kg			
54	Azid natriumi	Sodium azide, me formulë NaN_3 . Pluhur me pastërti \geq 99.5%. I përdorur në terrenet mikrobiologjike.	100,00	Gram			
55	Glukozë	Glucose. Sheqer, monosaccharid me formulë $C_6H_{12}O_6$. I përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike.	1.000,00	Gram			
56	Ekstrakt majaje	Pluhur; I përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike.	500,00	Gram			
57	Chloramfenikol	Chloramphenicol. Antibiotik i përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike. Me formulë: $C_{11}H_{12}N_2O_5$	0,20	Kg			
58	Endo agar	Terren për testet finale dhe konfirmuese të <i>coliforms</i> në ujë.	5,50	Kg			
59*	Blood agar	Terren bazë për përgatitjen e pjatave agar – gjak.	3,50	Kg			
60*	DC	Dezoksikolat citrate agar. I përdorur në përgatitjen e terreneve selektive për izolimin e bakteve enterike.	9,00	Kg			
61	Natrium	Pluhur me formulë: $HNaO_3Se$.	100,00	Gram			

Dokumentat Standarde të Tenderit

	hidro gjen selen it	I përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike selektive. Për izolimin e <i>Salmonellës</i> dhe <i>Shigellës</i> .						
62	Mani t	I përdorur në përgatitjen e terreneve mikrobiologjike.	500,00	Gram				
63 *	Bile salt	I përdorur në përgatitjen e terreneve selektive.	4,50	Kg				
64	Penic ilin	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve.	20,00	Flakon				
65	Ampi cilin	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve.	20,00	Flakon				
66	Bactr in	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve.	25,00	Flakon				
67	Cefe xim	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve.	20,00	Flakon				
68	Cefta zidim	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve.	20,00	Flakon				
69	Augu menti n	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve.	20,00	Flakon				
70	Piper acilli n	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve.	20,00	Flakon				
71	Mero pene m	Antibiotik, përdoret për të provuar rezistencën mikrobiale. Inhibon zhvillimin e baktereve.	20,00	Flakon				

Shumatore çmimi për njësi pa TVSH		330 185,03	
TVSH		66 037,006	
Shumatore çmimi për njësi me TVSH		396 222,036	
Fond Limit Vlerë e pritshme pa TVSH			8 617 550

TVSH	1 723 510,00	
Fond Limit Vlerë e pritshme me TVSH		10 341 060,00

1. Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër është **8'617'550** (tetë milion e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) **Lekë pa TVSH** dhe **10'341'060** (dhjetë milion e treqind e dyzet e një mijë e gjashtëdhjetë) **Lekë me TVSH**
2. **Shumatorja e çmimeve njësi: 330.185,03** (treqind e tridhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë presje zero tre) **Lekë me TVSH**
3. Burimi i Financimit: **Buxheti i Shtetit.**
4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: **Blerje Kite dhe Reagentë, për nevojat e NJVKSH”, për mbulimin e nevojave të NJVKSH për 12 muaj;**

2.9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj 12 ose ditë

ose

duke filluar nga / / me përfundim në / /

2.9.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër: 12 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër;

Kohëzgjatja në muaj: 12 ose ditë: (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër (jo më shumë se (4) vjet)

Ose duke filluar nga (dd/mm/vvvv)

Përfunduar më (dd/mm/vvvv)

2.10 Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës/marrëveshjes kuadër: Pranë Njësisë Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

2.11 Ndarja në LOTE:

Po Jo

Nëse po,

2.12 Përshkrim i shkurtër i loteve

(Objekti dhe fondi limit i LOTEVE)

2.13 Opsionet:

Numri i rinovimeve të mundshme (nëse ka):

Ose: nga në

2.14 Do të pranohen variantet:

Po Jo

2.14.1 Do të pranohet nenkontraktimi:

Po Jo

Nëse do të lejohet nenkontraktimi, te specifikohet përqindja e lejuar për nenkontraktim: _____

Autoriteti kontraktor do t'i bëjë pagesa të drejtpërdrejtë nenkontraktorit:

Po Jo

Shënime të tjera:

2.15. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po Jo

2.16. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standartet janë të pa-aplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po Jo

Seksioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

3.1 Kriteret e Pranimit sipas shtojcës 9.

3.2 Sigurimi i Ofertës²: (i zbatueshëm në rastin e procedurave të prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, në rast se kërkohet nga autoriteti kontraktor).

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, sipas Shtojcës 4. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është _____ Lekë (shuma e shprehur në fjalë).

Në rastet e dorëzimit të ofertës për Lote, vlera e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, për secilin nga Lotet është si më poshtë:

Loti 1 _____ Lekë

² Sigurimi i ofertes nuk kërkohet në procedurat e prokurimit me vlerë më të ulët se kufiri i lartë monetar

Loti 2 _____ Lekë

Seksioni 4 Procedura

4.1 Lloji i procedurës: E Hapur

Procedurë prokurimi e rishpallur

Po Jo **X**

Nëse është procedurë e rishpallur të plotësohen të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

- a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së prokurimit të anuluar: _____
- b) Objekti i prokurimit të procedurës së prokurimit të anuluar: _____
- c) Fondi limit i procedurës së prokurimit të anuluar: _____

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët X

Shënim: Marrëveshja Kuadër do të lidhet sipas çmimit më të ulët për njësi (shumatorës së çmimeve) për artikujt objekt prokurimi të OE fitues. Ky çmim nuk duhet të kalojë fondin limit për njësi (shumatoren) të përcaktuar në këto Dokumente Tenderit. Vlera totale e pritshme nuk duhet të kalojë vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër (në total). Në rast të kundërt oferta refuzohet.

Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, **çmimi më i ulët** bazohet në:

- i) çmimi i bursës, sipas Reuters lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili është publikuar në Buletinin e fundit të Njoftimeve Publike, para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave;
- ii) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi;
- iii) marzhi më i ulët i fitimit, të shprehur në përqindje.

Vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve.

Ose

B) oferta ekonomikisht më e favorshme

lidhur me rëndësinë: Çmimi pikë

etj. pikë

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **16.10.2020** (dd/mm/vvvv) Ora: **10:00**

Vendi: www.app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **16.10.2020** (dd/mm/vvvv) Ora: **10:00**

Vendi: www.app.gov.al

Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 150 (njqind e pesedhjetë) ditë

4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip Anglisht
Tjetër _____

Seksioni 5 Informacione plotësuese

5.1 Dokumenta me pagesë (i zbatueshëm vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):

Po Jo

Nëse Po

Monedha _____ Çmimi _____

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **23.09.2020**

Njoftimi i kontrates për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë
Adresa Rruga "Qamil Guranjaku,, Tirane
Tel/Fax Tel. +355 4347439
E-mail njvkshtirane@shendetesia.gov.al
(briken.lala@qsut.gov.al)
Faqja e Internetit _____

2. Lloji i procedurës se prokurimit: Procedurë e Hapur (Prokurim Elektronik) – Marrëveshje Kuadër me një OE me të gjitha kushtet e përcaktuara, me afat 12 muaj nga lidhja e MK.

3. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-72666-09-22-2020

4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: Blerje Kite dhe Reagentë, për nevojat e NJVKSH", për mbulimin e nevojave të NJVKSH për 12 muaj

5. Fondi limit: Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër: **8'617'550** (tetë milion e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) **Lekë pa TVSH** dhe **10'341'060** (dhjetë milion e treqind e dyzet e një mijë e gjashtëdhjetë) **Lekë me TVSH**

Shumatore Çmimi për Njësi: 330.185,03 (treqind e tridhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë presje zero tre) **Lekë me TVSH.**

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 12 Muaj nga lidhja e marrëveshjes kuadër.

7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **16.10.2020** (dd/mm/vvvv) **Ora: 10:00**

Vendi: www.app.gov.al

8. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **16.10.2020** (dd/mm/vvvv) **Ora: 10:00**

Vendi: www.app.gov.al

II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

Seksioni 1. Hartimi i ofertës

- 1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.
 - 1.2 Operatori Ekonomik përballon kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.
 - 1.3 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertes duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga Personi (-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.
 - 1.4 Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomik, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit
 - 1.5 Operatori ekonomik, mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës. Në rast verifikimi të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, apo të vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton e vërtetë, operatori ekonomik ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 13, pika 3, gërma (a) të LPP-së.
 - 1.6 **Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**
 - a) Formulari i Ofertës, plotësuar sipas Shtojcës 1 të DT ose Shtojcës 2 të DT (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje).
 - b) Dokumentat që lidhen me objektin e prokurimit (*skica, katalogje, kampione etj*)
_____,
_____,
_____.
 - c) Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas shtojcës 2/1.
 - ç) Dokumentat dhe vërtetimet e kërkuara në Shtojcën 8.
 - d) (Opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet)
- Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

Me plotësimin e Shtojcës “Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së Dispozitave Ligjore në Marrëdhëniet e Punës“, operatori ekonomik pranon se ka kontrata pune me çdo punëmarrës dhe që respekton të drejtat e punëmarrësve, sipas dispozitave të Kodit të Punës (ku përfshihen edhe të drejtat e gruas shtatzënë, gruas që sapo ka lindur dhe/ose gruas me fëmijë në gji, të parashikuara në nenet 104, 105, 105/a, 106, 108 dhe 115, dhe të legjislacionin të punës në tërësi.

- 1.7 Fshehtësia e procesit sipas nenit 25 të LPP-së.
- 1.8 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë vetëm ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: “Ofertë për furnizimin e mallrave; Nr e Njoftimit _
“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA dd/mm/vv _____ orës _____”

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.

- 1.9 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin ofertat e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t’i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: “**MODIFIKIM OFERTE**” ose “**TËRHEQJE OFERTE**”.

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, ofertuesi mund të modifikojë në çdo kohë ofertën deri përpara përfundimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave, pa patur nevojë për ndonjë komunikim me autoritetin kontraktor, pasi veprimet kryhen në llogarinë e tij, në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al.

Seksioni 2 Përlllogaritja e ofertës ekonomike

- 2.1 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar mallrat që do të lëvrohen, sasinë dhe çmimin e tyre.
- 2.2 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lekë), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen, por pa përfshirë TVSH. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.

- 2.3 Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të ofertës të të gjitha Mallrave, pa TVSH. Vlera e TVSH, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.
- 2.4. Në rastin e një marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet NUK janë përcaktuar, çmimet për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk janë të fiksuara; ato janë objekt i ndryshimit pas një mini-konkursi midis operatorëve ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër.
- 2.5 Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.
- 2.6 Sigurimi i Ofertës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
 - b) garanci sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet së bashku me ofertën para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

Dokumentat si më sipër duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Në rastin kur sigurimi i ofertës ka formën e një garancie bankare, Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

2.7 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës

Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë nga përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshëmrinë e ofertave, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim, dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor do të refuzojë ofertën.

- 2.8 Veprimet e jashtëligjshme sipas Nenit 26 të LPP-së

Seksioni 3. Vlerësimi i Ofertave

3.1 Kriteret e përzgjedhjes

(Opsioni 1) Çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar.

Kontrata do t'i akordohet atij Ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës.

Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, **çmimi më i ulët** bazohet në:

- i) çmimi i bursës, sipas Reuters lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili është publikuar në Buletinin e fundit të Njoftimeve Publike, para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave;
- ii) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni si dhe çdo taksë tjetër sipas legjislacionit në fuqi;
- iii) marzhi më i ulët i fitimit, të shprehur në përqindje.

Vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve.

(Opsioni 2) Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter dmth sa pikë do të ketë çdo kriter dhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = V_{min} k1 \times P_{max} k1 / O_{k1}$$

Pk1 _____	Pikët e kriterit që vlerësohet
V _{min} k1	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
P _{max} k1	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O _{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Sqarim: Si kriter vlerësimi duhet të përzgjidhet vetëm njëri prej opsioneve. Plotësimi i të dy opsioneve e bën procedurën të pavlefshme.

3.2 Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra

3.2.1 Autoriteti Kontraktor korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti Kontraktor e njofton menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.

3.2.2 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, si më mëposhtë:

- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shumat në fjalë lidhet me një gabim aritmetik;

- nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shumat në total, nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet *Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar*

3.3 Ofertat anomalisht të ulëta

3.3.1 Nëse oferta e dorëzuar, rezulton anomalisht e ulët në lidhje me mallrat e ofruara, atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën.

3.3.2 Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në nenin 66 të Kreut VII të RrPP .

Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 përqind e fondit limit të përlllogaritur.

Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 përqind e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Formula që do të zbatohet për të cilësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ka tre ose më shumë oferta të vlefshme është si më poshtë:

O – Oferta
M_O – Mesatarja e Ofertave të vlefshme
n – Numri i Ofertave të vlefshme
Z_M – Zbritja e Mundshme

$$M_O = O_1 + O_2 + O_3 + \dots O_n / n$$

$$Z_M = 85 \% M_O$$

Vlera e Ofertës që vlerësohet <Z_M..... , si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët

Në rastin kur kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme, do të verifikohet nëse ofertat janë anomalisht të ulëta vetëm nëse oferta e klasifikuar me pikët më të larta e ka ofertën ekonomike me vlerën më të ulët.

3.4. Ankimi administrativ në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë sipas nenit 63 të LPP-së.

Seksioni 4. Nënshkrimi i Kontratës

4.1 Njoftimi i fituesit

Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesin fitues, përmes dërgimit të njoftimit të fituesit, siç parashikohet në Shtojcën 14. Një kopje e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç kërkohet në Nenin 58 të LPP-së.

4.2 Sigurimi i kontratës

4.2.1 Autoriteti Kontraktor kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10 % e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, sipas Shtojcës 19 të DT, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

4.2.2 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

- i. garanci bankare
- ii. garanci sigurimi

Ky formular nuk përdoret nga autoritetet kontraktore në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale.

4.3 Njoftimi i kontratës së nënshkruar

Në pajtim me RrPP, pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktor dërgon një njoftim në APP për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Shënim: Autoritetet kontraktore nuk duhet të ndërhyjnë për të bërë asnjë lloj ndryshimi në dokumentat e tenderit nga pika 1 në pikën 4.

III. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DT:

Shtojca 1: Formulari i Ofertës ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje

Shtojca 2/1: Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur

Shtojca 3: Ftesa për Ofertë në rastin e Marrëveshjes Kuadër

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Formulari i Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik

Shtojca 7: Deklarata për konfliktin e interesit

Shtojca 8: Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme

Shtojca 8/1: Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave Ligjore në marëdhëniet e punës

Shtojca 9: Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes

Shtojca 10: Specifikimet teknike

Shtojca 11: Planifikimi i kontratave në marrëveshjen kuadër

Shtojca 12: Sasia e mallrave dhe kushtet e lëvrimit

Shtojca 13: Formulari për Njoftimin S'kualifikimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 15 Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomike të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 16: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës

Shtojca 17: Kushtet e Vecanta të Kontratës

Shtojca 18: Formulari i njoftimit të Kontratës së nënshkruar

Shtojca 18/1: Formulari i njoftimit të Kontratës së nënshkruar për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike

Shtojca 19: Formulari i Sigurimit të Kontratës

Shtojca 20: Formulari i Ankesës në Autoritetin Kontraktor

Shtojca 21: Draft Marrëveshja Kuadër ku Jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Shtojca 22: Draft Marrëveshja Kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

Shtojca 23: Formulari i Njoftimit të Anulimit

Shtojca 1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 2

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Marzhi ynë i fitimit i shprehur në përqindje është si më poshtë:

1	2	3	5
Nr	Përshkrimi i mallrave	Marzhi i fitimit i shprehur në përqindje	Afati i levrimit

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 2/1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË

Për paraqitje Oferte të Pavarur

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë: _____; nga Autoriteti Kontraktor: _____; me objekt: _____; me fond limit: _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik _____, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të: _____ që:
(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

Shtojca 3

[Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti kontraktor në Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit]

FTESA PËR OFERTË

(shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor)

fton për të paraqitur oferta në procedurën për furnizimin e mallrave të mëposhtme:

.....
.....
.....

(jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës dhe sasisë siç përkufizohet në Dokumentat e Tenderit (DT).

Vendi i Dorëzimit të Mallit

(jepni një përshkrim të shkurtër)

Malli duhet të dorëzohet brenda datës _____

Oferta duhet të paraqitet

.....[J
ep adresën e saktë]

Përpara

.....
[Përcaktoni datën dhe orën]

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese _____

Forma e komunikimit:

Me shkrim

elektronike (email, fax, etj)

Shtojca 4.

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik kur kërkohet nga autoriteti kontraktor*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data]

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të siguruar*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit*] me një vlerë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës ose ftesën për tender*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5

LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti]

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial

KUJDES

Çdo e dhënë, që nuk është regjistruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e _____ të personit juridik _____ deklaroj se:

